

# PROBLEME E DISKUTIME

FATMIR AGALLIU

## NDËRTIMI DËFTOR + EMËR I SHQUAR NË GJUHËN SHQIPE

Nëpër gramatika dhe studime të ndryshme është vënë në dukje një dukuri e tillë: përdorimi i emrit të përcaktuar nga një dëftor edhe në trajtë të pashquar, edhe në trajtë të shquar. Shkaqet e kësaj dukurie, si edhe rastet e përdorimit me faktorët e tyre kushtëzues, në përgjithësi nuk janë shpjeguar në mënyrë të kënaqshme.

August Dozoni radhit me të drejtë si në rastet e pashquarësisë, ashtu edhe në ato të shquarësisë ndërtimet me përemra dëftorë, por kur vjen puna për të shpjeguar trajtën e shquar, autori thotë se këtu «rregulla nuk është e përcaktuar mirë» dhe shton se «ajo është pozitive, kur emri ndiqet nga një përcaktor: t'i japë ujë asaj çupësë që ha dynjanë,...»<sup>1</sup> K. Cipo<sup>2</sup> ka vënë në këtë mes një kufizim, kur e lidh shfaqjen e trajtës së shquar vetëm me format e njëjësit (ky, kjo, ai, ajo), por nuk ka ndërmarre asnjë përpjekje për ta shpjeguar këtë dukuri dhe mjaftohet vetëm me konstatimin se përdoret zakonisht në popull, ndërsa për trajtën e pashquar gabimisht thotë se ka hyrë në gjuhën e shkrimit. Në të vërtetë të dy trajtat hasen në gjuhën e folur. Mbeten për t'u shpjeguar arsyet e përdorimit të njërës dhe tjetrës: *Ky i shoqi ksaj grues tuj ndie këto fjal, e nal kët djalin e pvet t'shoqen: «i kuj asht ky djal?»* (Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, I, 1961, f. 357).

Më vonë për këtë çështje Cipoja do të mbajë një qëndrim tjetër, duke ndjekur në përgjithësi Dozonin, por, ndryshe prej tij, jep një shpjegim vetëm për trajtën e shquar, që në thelb është i njëjti me atë të Dozonit: «Kur ka në krye një përemër dëftor: *ky, ai* dhe shoqërohet me një fjali. P.sh. . . . *Ky rrapi që ka këtë hie të ftohtë, është shumë' i vjetër.*»<sup>3</sup>

Sh. Demiraj<sup>4</sup> e shpjegon këtë dukuri (d.m.th. trajtën e shquar të një emri të paraprirë nga përemra dëftorë) si një shfaqje hiperkarakterizimi. Kjo është e vërtetë vetëm për ndonjë rast të veçantë përdorimi dhe nuk mund të shpjegojë dot gjithë shfaqjet e kësaj dukurie.

Shkakun kryesor të rastit më të rëndomtë të kësaj dukurie e ka zbuluar J. Rrota<sup>5</sup>, i cili vë në dukje se në këto përdorime përemri dëftor

1) Auguste Dozon, *Manuel de la langue chkipe ou albanaise*, 1879, f. 289.

2) K. Cipo, *Gramatika shqipe*, 1949, f. 101.

3) K. Cipo, *Sintaksa*, 1952, f. 16.

4) Sh. Demiraj, *Rreth kategorisë së shquarësisë dhe pashquarësisë në gjuhën shqipe*, «Studime filologjike», 4, 1969, f. 154.

5) J. Rrota, *Analyzimi i rasavet t'emnit e zhvillimi historik i tynve*, Shkodër, 1931, f. 27.

«nuk e ka më atë fuqin e natyrshme të shërbimit të vet» dhe dëftor «nji gjasend të përmendun pak para, a të dijtun». Kjo do të thotë se në të tilla ndërtime dëftori kryesisht nuk ka kuptim deiktik, por anaforik d.m.th. shërben për të referuar tek një emër që është zënë në gojë sipër. Shkakut i shquarësisë është ripërmendja e emrit, në pasojë të cilës sendi i emërtuar nga ky emër bëhet tashmë i njohur.

Përemri dëftor, i dobësuar kështu kuptimisht, afrohet me nyjen, jo me të përcaktuarën, siç shprehet Rrota<sup>6</sup>, por me atë të caktuarën, që bën që ai të qëndrojë në këto raste si diçka e tepërt, që edhe mund mos jetë aty «pa i prishë gja kuptimit»<sup>7</sup>, sepse është trajta e shquar emrit ajo që përmbush funksionet e tij. Për këtë arsye në gjuhën shkruar një dukuri e tillë, shumë e shpeshtë në gjuhën popullore në dy degëzimet kryesore dialektore, është mënjanuar pothuajse plotësisht. Ja disa shembuj nga gjuha e folur: *ish një mbret, ai mbreti kish një pelë. Ajo pela nuku pill. Tuj ardh u afrue shehrit vet afr, has një plak n'rru* i thot ky plak: ... (Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, I, 1980, respektivisht f. 378 dhe 356).

Në përmendjen e parë emri që shënon një send ende të panjohur vihet në trajtë të pashquar i shoqëruar nga nyja e pacaktuar *një*, që ka në këtë rast një funksion prezantues. Gjatë ripërmendjes, siç u pa edhe në shembujt e sjellë më sipër nga gjuha e folur popullore, ai mund të paraprihet shpeshherë edhe nga një përemër dëftor. Edhe në ripërmendjen e mëtejshme, si duket për një identifikim më të saktë emri i shquar mund të paraprihet, gjithmonë në gjuhën popullore, nga një përemër dëftor.

Përdorimi i shpeshtë i emrit, që shquhet për shkaqe të njohura dhe shoqërohet nga një përemër dëftor, nuk duhet të na bëjë të mendojmë se në gjuhën popullore emri i paraprirë nga dëftorët është zakonisht i shquar, siç pohon K. Cipo.<sup>8</sup> Kjo është vetëm një përshtypje e jashtme sepse si trajta e shquar, ashtu edhe e pashquara kanë ligjësitë e veta të përdorimit, që nuk varen gjithaq nga kjo në kemi të bëjmë me gjuhën popullore, apo letrare, sepse gjuha letrare ngrihet mbi bazën e gjuhës popullore. Prandaj çështja nuk duhej shtruar sikur «në togfjalëshat e tipit dëftor + emër ky i fundit përdoret shpesh i prapanyjzuar»<sup>9</sup>, por më drejt do të ishte të flitej për shoqërimin e emrave të shquar me përemra dëftorë.

Emrat në trajtë të pashquar shoqërohen me përemra dëftorë, kur bëhet fjalë për sende të papërmendura ende<sup>10</sup>, të cilët ndodhen afër, ose larg folësit. Në këtë rast sendet vetëm emërtohen me anë të emrit të përgjithshëm, që këtu përfaqëson mbarë klasën përkatëse, ku përfshihen këta sende, dhe rolin individualizues e luan dëftori, i përdorur me kuptim deiktik: *U nuk martonem pa marrë atë djalë, që të më pëlqenjë. ... atë njeri u e solla në kaikë time, dhe ai s'ka bërë gjë.* (Mbledhës. . . , I, resp. f. 367 dhe 368) Kur më ftuat për këtë vepër nga shërbimi i Sulltanit, kisha në zemër atë dëshirë që kishit edhe ju. (Fan S. Noli, Histori e Skënderbeut, 1962, f. 29).

6) J. Rrota, po aty, f. 27.

7) J. Rrota, po aty, f. 27.

8) K. Cipo, *Gramatika shqipe*, 1949, f. 101.

9) Sh. Demiraj, *artikull i cituar*, f. 154.

10) Shih edhe Dozon, *vepër e cituar*, f. 287.

Në gjuhën e shkruar emri i ripërmendur, që përndryshe do të vihej në trajtën e shquar, mund të shoqërohet gjithashtu nga një përemër dëftor dhe rrjedhimisht del i pashquar. Në këtë rast fjala e ripërmendur dallohet në një mënyrë më të theksuar, veçohet më mirë: *Ju atëhere dëgjuat një të shtënë pushke, — tha ai. — Ajo e shtënë na ndihmoi, Arif, se do të na kishin zënë të gjithë, — tha Memua.* (.D. Agolli, Komisari Memo, f. 31).

Në gjuhën e folur përemri dëftor mund të shoqërojë edhe emra që emërtojnë veta ose sende të pranishme dhe unike dhe që për këtë arsye dalin të shquar. Përemri dëftor edhe në këtë rast i shtohet emrit për përforsim dhe mund të hiqet pa i prishur gjë kuptimit: *Hipë! Le të hipë edhe kjo shoqja me këtë çunin.* (D. Agolli po aty, f. 5).

Në raste të tjera shquarësia e emrit mund të varet edhe nga përcaktorë të ndryshëm (duke përfshirë këtu edhe tipin e përcaktorit të shprehur nga një fjali e varur me kuptim veçues, kufizues, për të cilin bëjnë fjale Cipoja dhe Dozoni): *Në këto manovrimet tona i kemi dhënë përshtypje armikut se qëllimi ynë është që të shkojmë drejt Maqedonisë.* (M. Shehu).

Një çështje që del lidhur me dukurinë që morëm në shqyrtim, është edhe ajo e shtrirjes së saj. E. Hempi<sup>11</sup> këto kohët e fundit ka shprehur mendimin se në shqipen, në përgjithësi, ekziston rregulla sipas së cilës dëftori e kufizon emrin e përcaktuar prej tij në fleksionin e pashquar, ashtu siç ndodh në italishten, anglishten dhe në gjuhë të tjera.

Kjo është e vërtetë, siç u tha, vetëm për gjuhën e shkruar, ndërsa për gjuhën popullore haset gjithandej<sup>12</sup> po ai fenomen, që Hempi vë re në dialektet e Çamërisë dhe Arvanitika dhe për këtë arsye s'ka si trajtohet ndryshe, veç si një zhvillim i brendshëm i shqipes, që ka ligjësitë e veta, të cilat u munduam t'i shpjegojmë në këtë artikull. Ndikimi i greqishtes në këtë drejtim s'ka kuptim të shtrohet.

11) E. P. Hamp, *La langue albanaise e ses voisins*, në *Actes du premier Congrès international des études balkaniques e sud-est européennes*, VI, Linguistique, Sofia, 1968, f. 665. S.,fo

12) Citojmë, ndër shumë dëshmi, përrallat e Jarnikut treguar nga një shkodoran (Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, I, 1961) dhe studimin monografik të pabotuar «E folmja e Hasit» të Xh. Gosturamit.

